



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 461, datë 25.07.2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË KANCELARES SË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË, PËR SHKAK TË DORËHEQJES**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 25.07.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”, kërkesën për dorëheqje të Kancelares znj. {...}, pasi shqyrtoi propozimin e ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**V Ë R E N:**

**I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN DHE KËRKESËN**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 53, 55 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me vendimin nr. 496, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë” ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë, ndër të cilët edhe për znj. {...}, ish kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Në përfundim të kësaj procedure verifikimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 435 datë 04.10.2021 ka vendosur : “1. Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, znj. {...}....”.

3. Në vijim, pas ristrukturimit të gjykatave të apeleve në zbatim të hartës së re gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 63 datë 01.02.2023 ka vendosur : “1. znj. {...} aktualisht kancelare pranë Gjykatës së Apelit Durrës, transferohet në mënyrë të përhershme kancelar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.02.2023...”.

4. Me datë 14.07.2023, Znj. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i punës si kancelare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 80, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

5. Ndërkohë, në vijim të kërkesës për dorëheqje, me datë 19.07.2023, Znj. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë tjetër për dorëheqje nga pozicioni i punës si kancelare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 80, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke kërkuar përshejtimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës me arsyetimin anagazhimeve profesionale të saj pasi ka fituar provimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe është në procedurë verifikimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe fëmija i saj i mitur ka probleme shëndetsore dhe kërkon përkujdesjen e saj të vazhdueshme.

## **II. VLERËSIMI MBI FAKTIN E KONSTATUAR**

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka në kompetencë të tij, ndër të tjera, emërimin e kancelarëve të gjykatave. Në nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: “*Organi kompetent për emërimin e kancelares, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor ...*”.

7. Ndërkohë, lidhur me vijimin e marrëdhënies së punës dhe përfundimin e saj, në nenin 80 të Ligjit nr. 98/2016, parashikohet se: “...3. *Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën*”. Në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

8. Në nenin 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku ushtron detyrën, ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. 3. Në raste të justifikuar, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi. 4. Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”*. Referuar kësaj dispozite, rezulton se një ndër rastet e përfundimit për shkak të ligjit të marrëdhënies në shërbimin civil, është paraqitja e dorëheqjes me shkrim.

### **III. KONKLZIONI**

9. Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në kushtet kur për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga kancelarja në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë znj. {...}, vlerësohet se është vërtetuar një ndër shkaqet ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës, sipas parashikimeve të nenit 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar, marrëdhënia e punës duhet të deklarohet e përfunduar për shkak të dorëheqjes. Në kushtet kur kjo dorëheqje është trajtuar si e motivuar nga Këshilli, ajo do t'i prodhojë efektet përpara afatit 30 ditor nga njoftimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 80 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pika 3 të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, si dhe në kërkesën për dorëheqje të Kancelares të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, znj. {...},

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 25.07.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**